



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 371 Prot.

Tiranë, më 03.03 2019

VENDIM Nr. 25, datë 06.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2, datë 06.03.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC "MALI" në lumin e Tërkuzës, Bashkia Tiranë"*-subjekti "TIRANA ENERGJI" sh.p.k., realizuar nga individët e licencuar në arkeologji Neritan Ceka, Skënder Muçaj.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC "MALI" në lumin e Tërkuzës, Bashkia Tiranë"*-subjekti "TIRANA ENERGJI" sh.p.k., realizuar nga individët e licencuar në arkeologji Neritan Ceka, Skënder Muçaj.
2. Subjekti "TIRANA ENERGJI" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC "MALI" në lumin e Tërkuzës, Bashkia Tiranë", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**